

VENDIM
Nr. 3, datë 6.2.2020

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 4, DATË 11.3.2019, TË KËSHILLIT TË
EMËRIMEVE NË DREJTËSI, “PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË
KANDIDATËVE PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE
DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Kur procedura e verifikimit nuk ka përfunduar gjer më 31 dhjetor, atëherë afati i përcaktuar në pikat 3 dhe 4 është jo më vonë se 3 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit të radhës. I njëjti afat zbatohet edhe kur procedohet me zëvendësimin e relatorit për shkak të ligjshëm gjatë veprimtarisë së të njëjtit Këshill”.

2. Pas pikës 5, shtohen pikat 5/1 dhe 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1. Kur veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit nuk kanë përfunduar gjer më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera për të përfunduar me përparësi këtë fazë, duke konsideruar respektimin e afatit ligjor.

5/2. Kur relatori i ka përfunduar veprimet procedurale dhe verifikuese, por Këshilli nuk ka shqyrtuar çështjen gjer më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri, pasi kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera:

a) konfirmon procedurën e ndjekur dhe përcjell relacionin e hartuar prej tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit;

b) vijon kryerjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese shtesë.”.

3. Pas pikës 20, shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1. Kur akti apo shkresa e komunikimit për mbledhjen e të dhënave nga të tretët nënshkruhet nga Kryetari, atëherë përmbajtja e aktit apo e shkresës konfirmohet paraprakisht përmes nënshkrimit/siglimit ose postës elektronike nga relatori përkatës, praktikë e cila vendoset në dosjen e kandidatit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ardian Dvorani